



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 104

Tiranë – E mërkurë, 10 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 55/2017, datë 4.5.2017	Për mbylljen e legjislaturës VIII të Kuvendit të Shqipërisë..... 5721
Rezolutë e Kuvendit datë 4.5.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2016..... 5721
Rezolutë e Kuvendit datë 4.5.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2016..... 5723
Rezolutë e Kuvendit datë 27.4.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016..... 5725
Rezolutë e Kuvendit datë 4.5.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2016 5726
Rezolutë e Kuvendit datë 4.5.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2016..... 5728
Urdhër i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 284, datë 9.5.2017	Për miratimin e formularit të deklarimit të pasurive dhe interesave private (<i>Për kandidatët për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë</i>) 5730



VENDIM
Nr. 55/2017

PËR MBYLLJEN E LEGJISLATURËS VIII
TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, dhe të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Legjislatura VIII e Kuvendit të Shqipërisë mbyllet në datën 4.5.2017.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 4.5.2017

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
(KMD) PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke respektuar të drejtat themelore kushtetuese si të pacenueshme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme, në mbrojtje të së drejtës për barazi para ligjit, për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe në zbatim me efektivitet të politikave për mbrojtjen nga diskriminimi dhe parandalimin e tij, si përparësi për procesin e integritetit evropian të vendit;

- Në përmbushje të angazhimeve për garantimin e një shoqërie tolerante, demokratike dhe të drejtë, si parakusht për respektimin e çdo pakice, pjesë e shoqërisë shqiptare;

- Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2016:

- Sipas raportit të Komisionerit gjatë vitit 2016 grupet më të cenuara nga shkeljet diskriminuese janë komuniteti rom dhe egjiptian, personat me

aftësi të kufizuara, komuniteti LGTBI dhe gratë.

- Numri i ankesave të regjistruara dhe të trajtuara nga KMD-ja në vitin 2016 është më i ulët, krahasuar me vitin 2015, edhe pse në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”, kërkohej rritja e identifikimit të rasteve ku pretendohet diskriminim. Edhe në Progresraportin e BE-së për Shqipërinë të vitit 2016 konstatohet se “KMD-ja ka trajtuar një numër më të ulët të rasteve”.

- Ka një rënie të lehtë të numrit të çështjeve të nisura kryesisht gjatë vitit 2016, krahasuar me vitin paraardhës. Në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015” kërkohej rritja e hetimeve të nisura kryesisht.

- Është rritur pjesëmarrja e KMD-së në proceset gjyqësore, krahasuar me vitin 2015, duke përmbushur rekomandimin e rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”, ku kërkohej konsolidimi i mëtejshëm i rolit të KMD-së, lidhur me rastet e paraqitura në sistemin gjyqësor. Në Progresraportin e BE-së për Shqipërinë konstatohet se “KMD-ja të shtojë përpjekjet për të ndërtuar një jurisprudencë antidiskriminim që të jetë e qëndrueshme”.

- KMD-ja ka vijuar ndërgjegjësimin dhe informimin publik, nëpërmjet shpërndarjes së materialeve ndërgjegjëse, broshurave informative mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, botimeve, me vijimin e organizimit të ditëve të hapura me komunitetin, 19 sesioneve të trajnimit me punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Ka organizuar konferencën “Zbatimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi” me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, me përfaqësues nga institucionet qendrore dhe vendore, OJF-ve etj.

- Numri i ankesave për diskriminim, të paraqitura pranë KMD-së, për shkak të gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual e identitetit gjinor vijon të mbetet i ulët, në raport me sjelljet diskriminuese që këto grupe të cenuara përballen, referuar të dhënave të raportit vjetor. Në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”



kërkohej forcimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht organizatat që mbrojnë të drejtat e grupeve të dobëta, me qëllim identifikimin dhe shqyrtimin e rasteve të diskriminimit gjinor, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual ose identitetit gjinor, të referuara prej tyre.

- Shkaku për të cilin pretendohen më së shumti sjellje diskriminuese dhe që përbën edhe numrin më të madh të ankesave për këtë shkak, është raca. Krahasuar me vitin 2016 ka një rritje të ankesave ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, bindjeve politike dhe aftësisë së kufizuar.

- Numri i vendimeve që konstatojnë diskriminim mbetet i ulët, në raport me numrin total të vendimeve të dhëna, si dhe me numrin total të ankesave të paraqitura për shqyrtim, të cilat pretendojnë diskriminim. Në Progresraportin e BE-së për Shqipërinë, të vitit 2016, konstatohet se “Nevojiten më shumë përpjekje, për të zhvilluar historikun e rasteve kundër diskriminimit”.

- KMD-ja ka kontribuar në përmirësimin e legjislacionit, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke i propozuar 5 rekomandime legjislative autoriteteve përgjegjëse. KMD-ja ka përmblusur pikën 2 të pjesës rekomanduese të rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”.

- KMD-ja ka vendosur një numër më të ulët të masave administrative me gjobë, për moszbatim të vendimeve të tij, apo mosdhënie të informacionit nga ana e subjekteve, në raport me vitin paraardhës.

- KMD-ja ka kontribuar në hartimin e raporteve/raportimeve në kuadrin e organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë, si dhe procesin e integritetit europian. Ka përgatitur një studim krahasimor mes legjislacionit shqiptar dhe atij europian “Mbi kriteret e pranimit të punonjësve të policisë”, i cili është në fazën përfundimtare të hartimit.

- Në kuadër të projektit të përbashkët të BE-KE-së, “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”, KMD-ja ka zhvilluar takime institucionale, me ekspertë të KE-së, me qëllim hartimin e rekomandimeve prej tyre, ndër të tjera,

lidhur me vlerësimin e Planit Strategjik 2012-2015 të KMD-së, ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe kuadrin ligjor që lidhet me zbatimin e tij. KMD-ja ende nuk ka propozuar rekomandimet konkrete mbi përmirësimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- KMD-ja nuk ka paraqitur në raportin vjetor gjetjet dhe rezultatet e monitorimeve të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në fushën e punësimit, në sektorin privat dhe në gjykata, edhe pse në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015” kërkohej paraqitja e tyre.

Kuvendi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2017:

- Të vijoje përpjekjet për konsolidimin e mëtejshëm të rolit të tij, lidhur me rastet e paraqitura në sistemin gjyqësor, për zgjerimin e grupeve përfituese, në përmblusje të qëllimit dhe objektit ligjor, duke pasur në vëmendje reformën në sistemin e drejtësisë dhe rekomandimet konkrete në lidhje me procesin e integritetit europian të Shqipërisë.

- Të realizojë hartimin e strategjisë së veprimtarisë së institucionit (2017-2021), si dhe planin e tij të veprimit.

- Përpjekje më të thelluara në zbatimin efektiv të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të respektojë dhe të reflektojë dinamikën, në përputhje me ndryshimet kushtetuese, nëpërmjet zgjerimit të grupeve të asistuar, rritjes së numrit të rekomandimeve drejtuar autoriteteve përgjegjëse dhe konsolidimit të praktikës ligjore të institucionit.

- Të propozojë ndryshime dhe përmirësime ligjore, të kuadrin rregullator në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, që rrjedhin prej punës kërkimore dhe analizave studimore të rasteve të shqyrtuara nga KMD-ja, në përmblusje të cilësisë dhe profesionalizmit, si dhe në ndihmë të jurisprudencës në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Të monitorojë efektivitetin e ndryshimeve dhe përmirësimeve që ka pësuar kuadri ligjor gjatë vitit 2016 në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, të drejtave dhe lirive themelore, gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social, dhe efektivitetin e tyre nga institucionet shtetërore.



- Të realizojë monitorimin e aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve, arsimit dhe punësimit.

- Të konsolidojë mekanizmat ligjorë, për të forcuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me theks të veçantë mbrojtjen e të drejtave të grupeve të dobëta, bazuar në një plan veprimi të mirëpërcaktuar.

- Ndërmarrjen në vazhdimësi të fushatave ndërgjegjësuese për publikun dhe grupet e interesit, me qëllim rritjen e identifikimit dhe trajtimit të rasteve me objekt diskriminimin, si dhe në funksion të rritjes së çështjeve të nisura kryesisht.

- Të sigurohet roli më aktiv i KMD-së në mediat vizive dhe të shkruara, veçanërisht nga Televizioni Publik Shqiptar, si dhe televizionet me licencë kombëtare, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik lidhur me të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi.

- Të garantojë transparencën institucionale përmes përditësimit të faqes zyrtare të institucionit, me të gjitha aktivitetet institucionale, si dhe publikimin në vazhdimësi të të gjitha akteve, vendimeve, rekomandimeve, raporteve etj.

Miraturar në datën 4.5.2017

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE) PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke vlerësuar faktin që gjendja financiare në sistemin energjetik u karakterizua nga një performancë në rritje, veçanërisht në uljen e nivelit të humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

- Duke konsideruar si një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së Entit Rregullator të Energjisë mbrojtjen e konsumatorëve;

- Duke vlerësuar se përgjegjësia e ERE-s në zhvillimin e suksesshëm të tregjeve të gazit dhe energjisë elektrike është e madhe, si i vetmi ent që monitoron dhe vendos për zhvillimin e drejtë, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të tregut;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike garanton një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë të tregut të energjisë elektrike;

Për vitin 2016:

- Vlerëson bashkëpunimin e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në hartimin e projektligjit “Për performancën e energjisë së ndërtesave” (miraturar në nëntor 2016) dhe në hartimin e projektligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (miraturar në shkurt 2017).

- Vlerëson investimet e bëra nga OST dhe OSHEE në të gjithë vendin, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin cilësor të furnizimit me energji elektrike, në mënyrë të veçantë në zonat turistike të vendit.

- Vlerëson uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të cilat për vitin 2016 u ulën në masën 28,04 për qind kundrejt 31,34 për qind të një viti më parë, duke ruajtur trendin pozitiv rënës të këtij treguesi.

- Vlerëson certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, në kuadër të vendimmarrjeve të ERE-s, ky certifikim shënon një proces me mjaft rëndësi në kuadrin rregullator, por mbi të gjitha në implementimin e kërkesave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Vlerëson investimet e rëndësishme të bëra në rrjetin transmetues, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen edhe më tej të sigurisë së operimit të sistemit, në mënyrë të veçantë vënia në punë e sistemit të kontroll-monitorimit SCADA/EMS, OST siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit.

- Vlerëson vendimet e përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG të tre enteve rregullatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë.

- Vlerëson punën e bërë për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë, për të bërë të mundur krijimin e



një tregu konkurrues, eficient, që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend dhe e integron atë në tregun rajonal.

- Vlerëson punën e bërë për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë.

- Vlerëson bashkëpunimin me Komunitetin e Energjisë, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

- Vlerëson bashkëpunimin dhe konsultimin me Autoritetin e Konkurrencës lidhur me aktet e miratuara nga ERE.

- Vlerëson investimin e bërë dhe vënien në punë të centralit Fotovoltaik të UKKO sh.a., me kapacitet rreth 1 MW, si dhe inkurajon nxitjen e investimeve të tjera të ngjashme për prodhimin e energjisë nga dielli, era, biomasa etj., të cilat bëjnë të mundur diversifikimin e burimeve të energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend.

Rekomandon për vitin 2017:

- Në miratimin e tarifave të reja t’i kushtojë një vëmendje të veçantë, nga njëra anë, mbrojtjes së konsumatorëve për tarifa dhe çmime sa më të drejta e të përballueshme dhe, nga ana tjetër, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanisë.

- Të vijojë punën për nxitjen e krijimit të një tregu të brendshëm dhe hapjen efektive të tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, në veçanti, në dritën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke siguruar shërbime të drejta, të sigurta dhe të argumentuara për klientët dhe përdoruesit e sistemit energjetik në vend, si dhe të mbështesë investime strategjike dhe teknologjike, të cilat rrisin konkurrencën dhe përmirësojnë nivelin e shërbimeve në tregun e energjisë elektrike.

- Në kuadër edhe të ligjit të ri “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të bashkëpunojë me të gjithë aktorët, si dhe të luajë një rol proaktiv për krijimin e kushteve të nevojshme dhe nxitjen e investimeve për prodhimin e energjisë, jo vetëm nga burimet hidrike, por edhe nga era, dielli, biomasa etj., duke bërë kështu të mundur rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend, si dhe uljen e shkallës së lartë

të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në miratimin e planit të investimeve të OST-së dhe OSHEE-së, t’i kushtojë një vëmendje të veçantë rritjes së investimeve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit të konsumatorit me energji elektrike.

- Të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe me institucionet e tjera, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i hollësishëm i projekteve të reja të mundshme për ndërtimin e hidrocentraleve, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë impaktit në zona që përbëjnë interes të veçantë lidhur me natyrën.

- Të vijojë punën për hartimi dhe përmirësimin e një sërë aktesh nënligjore të sektorit të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat, tashmë, në funksion të ligjit të ri të sektorit, i pajisin palët e interesit me të drejta të plotësuara, por edhe i vendosin përpara detyrimeve të reja.

- Të rrisë përpjekjet e tij në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike, përmes publikimeve në faqen online të institucionit, si dhe mjeteve të tjera të komunikimit.

- Të kërkojë nga kompania “OSHEE” sh.a. anulimin e faturave të konsumatorëve nën emërtimin “dëm ekonomik” dhe “energji e pamatur” të periudhës 2008 - 2011, në zbatim të vendimit përkatës të ERE-s.

- Me gjithë uljen e ndjeshme të numrit të ankesave të konsumatorëve, krahasuar me një vit më parë, të vijojë trajtimin me seriozitet të tyre, duke kërkuar njëkohësisht një përgjegjshmëri më të lartë nga OSHEE-ja.

- Të vijojë monitorimin e ecurisë së treguesit të arkëtimeve të OSHEE-së, tregues i cili për vitin 2016 shënoi një rënie të lehtë krahasuar me një vit më parë, duke e konsideruar si një tregues shumë të rëndësishëm dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shlyerjen e pagesave ndaj palëve të treta.

- Të vijojë monitorimin e ecurisë së treguesit të humbjeve të OSHEE-së, për të bërë të mundur ruajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të trendit pozitiv rënës të këtij treguesi, i cili gjatë vitit 2016 pati një ulje të mëtejshme duke arritur në 28,04 për qind krahasuar me 31,34 për qind të një viti më parë.



- Të vijojë përpjekjet për shtimin e kapaciteteve në strukturën e saj, si dhe forcimin e profesionalizmit dhe të pavarësisë operationale të stafit të entit, në mënyrë që ERE të zhvillohet si një institucion i pavarur me kapacitete të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t'u përballur me sfidat e sektorit.

- Të marrë masat për heqjen e barrierave që pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj në treg dhe të sigurojë një përfitim të klientëve prej funksionimit të efektshëm të tregut kombëtar.

- Të vazhdojë bashkëpunimin me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë si në kuadër të projektit TAP, ashtu edhe për të përfituar nga eksperiencia e Rregullatorit Italian në sektorin e gazit natyror dhe sektorin e shpërndarjes.

- Me miratimin e ligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (miratuar në shkurt 2017) të fillojë punën për hartimin e akteve nënligjore, si dhe rregulloreve të nevojshme në kuadër të tij.

- Me miratimin e ligjit “Për gazin natyror” dhe në kushtet kur Shqipëria është një ndër vendet e para në rajon të implementimit të Paketës së Tretë të Energjisë kërkohet një angazhim më i madh i ERE-s, si dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha institucionet e tjera që kanë lidhje me këtë problem.

- Të marrë masat e nevojshme për plotësimin e kuadrit të legjislacionit sekondar, në përputhje me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së, të domosdoshëm për certifikimin e Albagazit, si operator i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Ky certifikim i paraprin hapit tjetër të rëndësishëm, i cili është dhënia e licencës së aktivitetit të operatorit të transmetimit dhe shpërndarjes Albagazit.

- Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Miratuar në datën 4.5.2017

KRYETARI
Ilir Meta

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;

- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore e ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;

- Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut, për t'i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2016 në drejtim të:

- Ndërhyrjeve të vazhdueshme në tregjet me problematika të përsëritura, për të identifikuar dhe ndaluar sjelljet abuzive në tregje;

- Rritjes së rolit të Autoritetit të Konkurrencës në hetimin e tregjeve të rregulluara;

- Fillimit të ciklit të trajnimeve të gjyqësorit, për aspekte të ligjit të konkurrencës dhe zbatueshmërisë së tij në praktikë;

- Kornizës legjislative gjerësisht në përputhje me *acquis* dhe dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- Përmbytjen e detyrimeve të MSA-së, ku Autoriteti drejton zbatimin e masave që ndikojnë në forcimin e advokacisë dhe të kulturës së konkurrencës;

- Rritjen e numrit të përqendrimeve të njoftuara në Autoritet në një sërë tregjesh kryesore;

- Hetimet e tregjeve kryesore dhe sensitive si: tregu financiar, tregu farmaceutik, ushqimor, agrobiznes, që japin impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar;

Kuvendi rekomandon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2016, të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të vazhdojë monitorimin e tregut të karburanteve për të siguruar që sjellja e ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në këtë treg nuk bie ndesh me ligjin dhe politikën e konkurrencës, si



edhe të ndjekë zbatueshmërinë e rekomandimeve të dhëna për tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta, tregun farmaceutik, si dhe tregun e prokurimeve publike.

2. Të monitorojë zbatimin e rekomandimeve, në lidhje me hetimin e përgjithshëm në sektorin bankar, për përmirësimin e mjedisit konkurrues në këtë treg jetik për ekonominë shqiptare.

3. Të realizojë advokacinë e zbatimit të programit të lehtësimit nga gjrobat, duke synuar rritjen e numrit të aplikimeve dhe ndërgjegjësimin për përfitimet që vijnë nga ky program.

4. Të vijojë me organizimin e trajnimeve për sistemin gjyqësor, si një domosdoshmëri për garantimin e cilësisë së vendimeve të marra.

5. Të përmirësojë mekanizmat e bashkëpunimit me institucionet publike, në funksion të përmbushjes së detyrimit të nenit 69, të ligjit nr. 9121, datë 27.3.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

6. Të realizohet objektivi mbi rishikimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe akteve nënligjore në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së.

7. Të forcojë kapacitetet e tij institucionale dhe njerëzore, me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit dhe inspektimit, hartimit të raporteve, cilësisë së mbrojtjes së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në proceset gjyqësore.

8. Të vazhdojë advokacinë e konkurrencës, duke promovuar një mjedis konkurrues, dhe rritjen e ndërgjegjësimin publik për përfitimet që vijnë nga konkurrenca.

Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të Ekonomisë;

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

Miraturar në datën 27.4.2017

KRYETARI

Ilir Meta

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2016**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Mbështetur në objektivat që udhëheqin veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe masat e marra në përmbushjen e tyre;

- Duke vlerësuar kontributin që ka dhënë politika monetare në rritjen ekonomike të vendit;

- Duke u mbështetur në strategjinë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë;

- Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike kombëtare, rajonale e botërore në politikat e ndjekura nga institucioni;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, për vitin 2016, në drejtim të:

- Lehtësimit të politikës monetare në funksion të objektivit të saj kryesor, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, dhe kontributit të saj në reduktimin e kostos së financimit në të gjitha segmentet e tregut financiar;

- Harmonizimit të politikës fiskale konsoliduese me politikën monetare lehtësuese e stimuluese, për të arritur objektivin në treguesin e inflacionit;

- Përpjekjeve për rigjallërimin e kreditimit nëpërmjet reduktimit të kostove të financimit, përgatitjes së ligjit për falimentimin, përmirësimeve në ligjet për shërbimin përmbarimor dhe Kodin e Procedurës Civile, zbatimit të masave kundërciklike, si dhe mbikëqyrjes së procesit të kredidhënies nga bankat e nivelit të dytë;

- Kontributit të politikës monetare në vijimësinë e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, të shprehur në treguesit e shëndetit të veprimtarisë së sektorit bankar, siç janë kapitalizimi, likuiditeti dhe përfitueshmëria, të cilët janë mbi nivelin e treguesve rregullatorë përkatës;

- Konsolidimit të objektivit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe përafrimit të praktikave mbikëqyrëse me standardet europiane;



- Përpjekjeve për të nxitur përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike në vendin tonë, duke rishikuar kuadrin rregullator përkatës;

- Përmirësimin e administrimit të rrezikut operacional, nëpërmjet ngritjes së strukturës përkatëse dhe përmirësimit të kontrollit të brendshëm;

- Ndryshimeve të rëndësishme rregullatore në lidhje me aktivitetin e menaxhimit të fondeve logjistike në Bankën e Shqipërisë dhe informatizimit të veprimtarisë së CASH-it;

- Rishikimit të metodologjisë për vlerësimin e rezervave valutore në shërbim të rritjes së efikasitetit gjatë administrimit të fondit të rezervës valutore;

- Komunikimit të shpeshtë dhe transparent me publikun në funksion të zgjerimit dhe thellimit të kulturës financiare.

Kuvendi rekomandon që Banka e Shqipërisë për vitin 2017:

1. Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë të ndjekë politika që synojnë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si kusht për stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik dhe për prime të reduktuara të rrezikut dhe të përpiqet në vazhdimësi për një harmonizim sa më të mirë të politikës monetare lehtësuese e stimuluese me politikën konsoliduese fiskale.

2. Mekanizmi i politikës monetare duhet të përmirësohet më tej nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse qeveritare, për shkak të ndikimit që ai ka në arritjen e objektivit kryesor dhe në rritjen ekonomike të vendit.

3. Banka e Shqipërisë duhet të forcojë kontributin e saj në drejtim të rritjes së kreditimit të ekonomisë, i cili është faktori kyç për mbështetjen e veprimtarisë së biznesit dhe zgjerimin e rritjes ekonomike. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të cilësisë së kredidhënies, duke e orientuar atë drejt sektorëve strategjikë të ekonomisë së vendit.

4. Me synim reduktimin e nivelit të kredive me probleme, Banka e Shqipërisë duhet të forcojë mbikëqyrjen e bankave për parandalimin e krijimit të kredive të reja me probleme, përmirësimin e politikave dhe cilësisë së kreditimit, ristrukturimin e hershëm të kredive, si dhe hartimin dhe rishikimin e planeve, duke ruajtur nivelet e kuadrit rregullator në drejtim të provigjoneve dhe kapitalizimit.

5. Të rriten përpjekjet në drejtim të zgjidhjes së

kredive me probleme për huamarrësit e mëdhenj të ekspozuar ndaj disa bankave dhe të rritet bashkëpunimi midis bankave për adresimin e problematikave të kredimarrësve të përbashkët.

6. Banka e Shqipërisë duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për të marrë masa në drejtim të reduktimit të nivelit të euroizimit në mënyrë graduale, për të siguruar uljen e ekspozimit të ekonomisë sonë ndaj këtij rreziku dhe rritjen e efektivitetit të politikës monetare.

7. Roli mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë duhet të forcohet më tej, në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar, adoptimit të standardeve ndërkombëtare, si dhe identifikimit e vlerësimit paraprak të rreziqeve, për të kufizuar ekspozimin e sektorit bankar ndaj rreziqeve të brendshme e të jashtme.

8. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, duhet të ndërmarrë nisma për të nxitur diversifikimin dhe thellimin e sistemit financiar në vend, duke u krijuar bankave dhe ndërmjetësuesve financiarë jobankarë mundësi të barabarta në treg, administrim më të shëndetshëm të rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të kredisë, si dhe mundësi më të mira financimi si periodikisht, ashtu edhe në raste të jashtëzakonshme.

9. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me institucione të tjera, duhet të ndërmarrë nisma për nxitjen e tregjeve të kapitalit në nivel vendor, për të siguruar diversifikimin e burimeve të financimit për korporatat e mëdha, për të lehtësuar procesin e ristrukturimit financiar të tyre dhe për të nxitur financimin afatgjatë të tyre.

10. Banka e Shqipërisë duhet të zgjerojë e të forcojë bashkëpunimin me bankat e nivelit të dytë në drejtim të zbatimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator. Në këtë kuadër, duhet të finalizohet puna për përmirësimin e ligjit për Bankën e Shqipërisë, në drejtim të rritjes së pavarësisë së institucionit dhe pasqyrimin të praktikave më të mira europiane.

Miraturar në datën 4.5.2017

**KRYETARI
Ilir Meta**



**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)
PËR VITIN 2016**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke e konsideruar si shumë të rëndësishëm forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të këtij rregullatori në përmbushjen e misionit të tij;

- Duke vlerësuar që legjislacioni i ri në shërbimin postar kërkon një rregullator të fortë dhe plotësisht të pavarur, që ka kompetenca të plota në rregullimin e shërbimit postar, në veçanti në dritën e liberalizimit të këtij tregu;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në nxitjen e teknologjive të reja, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më eficientë;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimit të mbrojtjes së interesave të përdoruesve;

- Duke konsideruar strategjinë broadband si tepër të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve të reja në fushën e komunikimeve elektronike;

Për vitin 2016:

- Vlerëson përpjekjet për krijimin e kushteve për zbatimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nxitjes së përdorimit racional dhe eficient të burimeve të kufizuara.

- Vlerëson reduktimin e ndjeshëm të hendekut midis thirrjeve on-net/off-net dhe trendin konverguës të tyre gjatë vitit 2016.

- Vlerëson punën e bërë në mënyrë të vazhdueshme për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të autorizimeve individuale, përmes informatizimit të sistemit të aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuenca dhe për numra.

- Vlerëson progresin e mëtejshëm në implementimin e planit të përdorimit të frekuencave, në mënyrë të veçantë për alokimin e brezave të disponueshëm të frekuencave për operatorët në treg.

- Vlerëson rritjen e aksesit në shërbimet fikse me brez të gjerë (broadband).

- Vlerëson implementimin e Numrit European të Emergjencave 112, i cili tashmë është në përdorim në zonën e Tiranës dhe do të vazhdojë të shtrihet në mënyrë progresive në të gjithë vendin.

- Vlerëson punën e bërë për plotësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator në fushën e shërbimeve postare, në përmbushje të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

- Vlerëson kontributin e AKEP-it në hartimin e ligjit të ri nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

- Vlerëson punën e bërë nga AKEP-i gjatë vitit 2016, në bashkëpunim me OSHEE-në dhe sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, për largimin dhe sistemin e kabllave nga shtyllat e OSHEE-së dhe shtyllat e ndriçimit të bashkive, masat e marra kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e rrezikshmërisë të këtyre instalimeve për jetën e personelit të sipërmarrësve, përmirësimi i mirëmbajtjes si të rrjeteve të komunikimeve elektronike, por dhe të energjisë dhe ndriçimit.

- Vlerëson rritjen e kapaciteteve të AKEP-it, të cilat kanë pasur qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së punës së institucionit, duke forcuar bashkërendimin dhe koordinimin e punëve midis strukturave, përshtatjen e tyre me detyrat dhe sfidat e reja që burojnë nga objektivat strategjike të institucionit, si dhe arritjen e standardeve europiane.

- Vlerëson rritjen e ndjeshme të përdorimit të shërbimit të aksesit broadband celular në terma përdoruesish dhe trafikut të të dhënave gjatë vitit 2016.

- Vlerëson rritjen gjatë vitit 2016 të numrit të inspektimeve të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare për evidentimin e rasteve të shkeljeve dhe marrjen e masave, sipas legjislacionit përkatës.

Rekomandon për vitin 2017:

- Të marrë masa për rritjen dhe forcimin e rolit të autoritetit rregullator në mbrojtjen e konsumatorit në tregun e komunikimeve elektronike dhe në tregun postar, për të garantuar mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në aspektin individual dhe në tërësi, nga sjelljet



diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike dhe në tregun postar, si dhe një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë përdoruesve përmes procedurave ligjore e transparente.

- Të vijojë punën për përfundimin e analizës së tregut të telefonisë celulare, e cila ka filluar në dhjetor të vitit 2016, dhe të marrë vendimet përkatëse, me profesionalizëm, transparencë e paanësi, për të bërë të mundur garantimin e një tregu në mbrojtje të interesave të përdoruesve, si dhe për të garantuar një konkurrencë të ndershme dhe jodiskriminuese të operatorëve në këtë treg.

- Të marrë masa për nxitjen e konkurrencës efikente dhe investimeve në tregun e komunikimeve elektronike. Nxitja e konkurrencës efikente në tregun e komunikimeve elektronike duhet të vijojë të jetë edhe për vitin 2017 objektivi kryesor rregullator.

- Të marrë masat e nevojshme për kryerjen e analizës së tregut të telefonisë fikse.

- Të marrë masa për administrimin efikent të spektrit të frekuencave dhe dhënien në përdorim të frekuencave në brezat që mundësojnë rritjen e kapaciteteve transmetuese për ofrimin e shërbimeve celulare 4G dhe ofrimin e shërbimeve 5G në të ardhmen sa më të afërt.

- Të marrë masat e nevojshme për hartimin e dokumenteve mbi strategjinë dhe objektivat për futjen e shërbimeve të lëvizshme në brezat e frekuencave 800 MHz, duke qenë se ecuria procesit të kalimit të transmetimeve audiovizive nga analoge në digjitale parashikon që në vitin 2017 ky brez do të kalojë në administrimin e AKEP-it.

- Të vijojë të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse (8,8 për qind), e cila mbetet në nivele të ulëta jo vetëm krahasuar me vendet e zhvilluara (rreth 40 për qind), por edhe rreth dy herë më e ulët se mesatarja botërore, madje edhe më e ulët se mesatarja e vendeve në zhvillim (10 për qind).

- Të marrë masa për forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjorë të tregut të komunikimeve elektronike të shërbimit postar për të garantuar trajtimin e barabartë ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre.

- Të marrë masat e nevojshme për të bërë të mundur publikimin në faqen web të AKEP-it të

informacionit krahasues të tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të pasurimit të faqes me informacione, të cilat i vijnë në ndihmë si përdoruesve, ashtu edhe operatorëve të komunikimeve elektronike dhe postare.

- Të marrë masat për përmbushjen e detyrimeve, si dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të nevojshme, në kuadër të ligjit të ri nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

- Të marrë masa për ushtrimin e kërkesave rregullatore në adresë të sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike për zbatimin e standardeve teknike, në përputhje të plotë me kërkesat dhe rekomandimet e ITU, si dhe të treguesve cilësorë (QoS) të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve.

- Të marrë masat e nevojshme për ndjekjen në vazhdimësi të përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga operatorët, si dhe të vijojë bashkëpunimin me institucionet shtetërore si ministrinë, njësitë vendore, Autoritetin Rrugor Shqiptar etj., në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it”, të ndryshuar, për mbulimin me shërbim në zonat me densitet të ulët të popullsisë me shërbime broadband dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

- Të vijojë monitorimin e mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në qytetet kryesore të Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe pikat turistike, si dhe në zonat me densitet të ulët të popullsisë, të cilat do të mbulohen me shërbime broadband.

- Të marrë masa për administrimin e interferencave dhe zgjidhjen e tyre në rastet e ankesave për ndërhyrje të dëmshme që vijnë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

- Të monitorojë me rigozitet zbatimin e rregullave teknike, të përcaktuara në rregulloren nr. 22, datë 24.6.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës rrjeteve kablllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”, për stabilizimin dhe standardizimin e rrjeteve kablllore të komunikimeve elektronike, situatë e cila, me gjithë përmirësimet e bëra, mbetet akoma problematike.



- Të vijojë punën për nxitjen, rritjen dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimit postar, si dhe të ndjekë dhe të zbatojë me rigorozitet dhe transparencë procedurat administrative për dhënien e autorizimeve përkatëse për ofrimin e shërbimit postar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve rregullatore të sektorit postar.

